



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN KOORDINIMIT DHE INFORMIMIT PUBLIK  
SEKTORI I ZYRËS ME NJË NDALESE

Nr. 325 / Prot.  
1

Patos, më 21 / 02 / 2022

PROCES-VERBAL

Ë mbajtur sot në datë 17.02.2022 ora 14:00 në ambientet e sallës së Këshillit të Bashkisë Patos ku organizohet seanca dëgjimore lidhur mbi "Miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij"

Pjesëmarrës në këtë mbledhje janë:

1. Anëtar të Këshillit Bashkiak
2. Të rinj të qytetit Patos
3. Përfaqësues të Shoqërisë Civile
4. Z.Gerti Shella drejtues i Infocip
5. Përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë

Takimi hapet nga Drejtoresha e Integrimit Evropian Koordinimit të Fondeve të Huaja dhe Informimit Publik znj. Elda Goxhaj

Elda Goxhaj – jam shumë e lumtur që e shoh këtë sallë mbushur plot me të rinj dhe më lejoni që të shpreh falenderimet e mia për vëmendjen që i keni kushtuar këtij takimi të sotëm lidhur mbi prezantimin e kriterëve të procedurës së përzgjedhjes për të qenë pjesë e antarësisë së Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij si një Këshill Rinor konsultativ pranë Bashkisë Patos. Në panel me mua është dhe z. Gert Shella Drejtues i Infocip, Znj. Nevila Jahaj Drejtuese e Qendës Rinore " Epoka e Re" z.Ervis Ruçi anëtar i Këshillit Bashkiak dhe zj.Nurkë Hazizaj juriste e bashkisë.

Elda Goxhaj – përpara se në të prezantojmë kriteret e përzgjedhjes po ia jap fjalën të ftuarve

Gerti Shella – kur kam marrë ftesën nga Elda për të parë dhe ndjekur nga afër se si realizon Bashkia takimet konsultative nuk hezitova por e pranova ftesën menjëherë dhe jam shumë i lumtur që ndodhem sot këtu jo vetëm për faktin se do të ndjek nga afër një dëgjese publike por kur e shoh këtë sallë të mbushur plot me të rinj të cilët shprehin interesin dhe ambicien e tyre pozitive për të qenë pjesë e këshillave pranë bashkisë INFOCIP do të mbikqyrë proceset konsultative që iniciohen nga administrata e Bashkisë Patos në ushtrimin e funksioneve të saj me qëllim nisjen e një programi kombëtar që synon të sjellë më pranë grupet e interesit me organet e qeverisjes vendore. Edhe një herë ju përgëzoj për nismën.

Adresa: Lagja "Nafëtari", Rruga "Unaza", Patos

Ervís Ruçaj – jam shumë i lumtur që jam pjesë e këtij takimi konsultativ, në fillimet e para të mia edhe unë ashtu si ju kam qenë aktivist në takime dhe organizata të ndryshme dhe sot jam anëtar i Këshillit të Bashkisë. Ndaj në këndvështrimin tim ju jenë kolegët e mi dhe padyshim mbështetës të Këshillit Bashkiak.

Nevila Jahaj – ju falenderoj për ftesën Elda, kisha besim se të rinjtë do të përgjigjeshin kërkesës për të qenë pjesë në këtë takim ku padyshim ju sot do të njihni të rinjtë lidhur mbi gjithë procedurën për të qenë pjesë e këshillit rinor pranë Bashkisë Patos. Ekzekutivi i bashkisë do t'ju bëjë një përmbledhje lidhur mbi ligjin e rinisë dhe më pas do t'ju prezantojnë lidhur mbi kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes.

Nunkë Hazizaj - prezanton interpretimin ligjor të ligjit Nr. 75/2019 “Për Rininë” Dhe Akteve Nënligjore në zbatim të tij siç janë VKM Nr. 681, datë 02.09.2020, “Për Mënyrën e krijimit, të Organizimit dhe Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe VKM Nr. 969, Datë 02.12.2020, “Për Përcaktimin e Kriterëve Dhe Procedurave të Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij”.

Nevila Jahaj - Për t'ju thjeshtuar më shumë Elda do të prezantojë kriteret mënyrat për tu përzgjedhur anëtar i Komisioni Rinor Vendor

Elda Goxhaj – siç e tha edhe Nurka ky është një ligj i ri dhe ne kemi detyrimin ligjor të implementimit të tij duke parë hapësirën dhe mundësinë për krijimin e këshillit rinor.

Elda Goxhaj – prezanton kriteret e procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij.

Nevila Jahaj – Organizatat kanë lobuar fort për hartimin e ligjit të Rinisë i cili ka patur konsultim të gjerë publik në të gjithë vendin edhe pse në parlament ka patur mjaft kontestime për këshillat rinorë. Padyshim që ky ligj në të ardhmen do të kërkojë ndryshime dhe përmirësime por ajo që unë doja të thoja është aktivizimi juaj në këshillat rinor.

Elda Goxhaj – Bashkia Patos shumë shpejt do të hapë thirrje për projekte të dedikuara vetëm të rinjve ku ju mund të aplikoni me idetë dhe projektet tuaja

Marjua Kamberaj ( nxënëse e shkollës “ Sotir Capo) – unë kërkoj që idetë të mos jenë individuale.

Gerti Shella – idetë janë aty vetëm duhet një interpretim i mirë, psh. dikur me Nevilën kemi qenë pjesë e projektit të Wikendit dhe me pedagogët tanë më të mirë vinim në kampin e punëtorëve në Vlorë dhe kjo ka qenë një eksperiencë 6-mujore tepër e vyer për ne që edhe sot e kujtojmë me nostalgji. Jua thashë këtë pasi të rinjtë kërkojnë dhe janë një burim idesh të pashtershme

Pranvera Jajaj ( nxënëse e shkollës “ Sotir Capo) – jam shumë e lumtur për ftesën për të qenë pjesë e komisionit rinor këshillimor.

Enejda Brace ( nxënëse e shkollës “ Sotir Capo) – ne nxënësit e shkollës “ Sotir Capo” kemi qenë aktiv në të të gjitha aktivitetet që ka organizuar bashkia por ne kemi një

problem me transportin dhe na vjen keq që për këtë arsye ne nuk kemi mundur dot të vinim ne dy aktivitetet e fundit.

Gerti Shella – e kuptoj shqetësimin tuaj dhe unë po ju premtoj që INFOCIP do të mbulojë shpenzimet e transportit për ju.

Elda Goxhaj – ky është një fillim i mbarë

Gerti Shella – ajo që unë do të shtoja është fakti se do të doja të njihesha me nevojat e të rinjve me qëllim që të kemi mundësinë e hartimit të një plani vjetor dhe le të jetë ky një fillim i mbarë siç e theksoj edhe Elda më qëllim dhe shpresë që gjërat të venë mirë deri në fund të vitit dhe ju premtoj se nëse Nevila sot do të jetë me një spot ne së bashku në fund të vitit do të jemi me një dokumentar.

Elda Goxhaj – të falenderoj Gerti për iniciativën dhe kurajon që iu jep të rinjve, ne do të takohemi shumë shpesh për të rrahur mendimet dhe idetë tuaja më të mira për të aplikuar në projektet më të mira që ju do të prezantoni. Edhe një herë faleminderit.

**Koordinator  
Për Konsultimin Publik  
Suzana Hysenaj**

